




KONTRATË PUBLIKE - PUNË

TITULLI I KONTRATËS

Përshkrimi i Kontratës: *Mirëmbajtja e objektit të Njesisë për Zjarrfikje dhe Shpëtim në Mitrovicë.*

Nr. i prokurimit ¹	642-24-5299-2-3-6
Nr i brendshëm	642-24-026-2-3-6



AUTORITETI KONTRAKTUES - Komuna e Mitrovicës Jugore, në njërën anë;

dhe

OPERATORI EKONOMIK - "LILI GROUP" SH.P.K., ULQINIT, -, ZHABARI IEPËRM në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë si në vijim:

Neni 1 – Lënda

1.1. Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:
Mirëmbajtja e objektit të Njesisë për Zjarrfikje dhe Shpëtim në Mitrovicë.

1.2. Kontrata hynë në fuqi me **05.07.2024** dhe përfundon në datë **05.09.2024**.

1.3. Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4. Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë Objekti i Njesisë së Zjarrëfikësve.

1.5. Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 – Ligji i aplikueshëm

2.1. Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 – Çmimi

3.1. Çmimi total i punëve duhet të jetë: **9,870.00 Euro** ose me fjalë (nëntëmijë e tetëqindë e shtatëdhjetë euro).

3.2. Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

Neni 4 – Pagesat

4.1. Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas punëve të kryera në shumën totale të pagesës pas pranimit të shërbimeve dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri i kontratës.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë.

4.2. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 – Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2. Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës

Neni 6 – Kualiteti

6.1. Kualiteti i (Punëve) duhet në të gjitha aspektet të plotësoj kushtet e parapara për shërbimet si në përshkrim të çmimeve të parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe për kryerje të shërbimeve do të jetë në kordinim të plotë me Njësinë kërkuese dhe Menaxherin e Kontrates gjatë implementimit të punëve.

Neni 7 – Garancioni

7.1. Garancioni do të mbetet valid për kohën deri sa të Implementohen shërbimet e eventit në fjalë për dëmtimet gjatë implementimit të shërbimeve për të cilin është përgjegjës kompanija që kryen punët.

Neni 8 – Vonesat në ekzekutim

8.1. Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *(të kryej ndonjë ose të gjitha punët)* brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *(punëve)* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 – Inspektimi dhe testimi

9.1. Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë shërbimet gjatë realizimit dhe të kërkoj sqarime nga kryesi i Shërbimeve, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes së eventit sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 – Nën-kontraktimi

10.1. Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 – Ndërprerja e kontratës nga Autoriteti Kontraktues

11.1. Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim:

- a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar;
- c) Refuzon urdhat administrativ të Autoritetit Kontraktues;
- d) Ia jep dikuj kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti Kontraktues;
- e) Falimenton;
- f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*;
- g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare;
- h) Shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 – Ndërprerja e kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1. Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti Kontraktues:

- a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë;
- b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë;
- c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 – Komunikimi

14.1. Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Kjo kontratë është hartuar në gjuhën (Shqipe) në katër (4) origjinale, tre origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Ti dorëzohet:


1x1 Original për Njësien kërkuese;

1x1 Original për Drejtorinë për Buxhet dhe Financ;

1x1 Original për Zyrën e Prokurimit dhe

1x1 Original për Kontraktuesin.

Palët nënshkruese:

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna e Mitrovicë Jugore	
Emri:	Kushtrim MEHAJ
Pozita:	U.D.Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data & Vula:	05.07.2024



Për Autoritetin Kontraktues: Komuna e Mitrovicë Jugore	
Emri:	Bedri HAMZA – Kryetar i Komunës së Mitrovicës Jugore
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data & Vula	

Për Operatorin Ekonomik: "LILI GROUP" SH.P.K., ULQINIT, -, ZHABARI IEPËRM"

Emri:	Halil Ahmeti
Pozita:	Drejtor (Pronar i Kompanisë)
Emaili	liligrup@hotmail.com
Nr UNIK	600637203
Nr i tel	+383/49 266 705
Nënshkrimi:	
Data & Vula:	05.07.2024



KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha shqipe.
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 05.09.2024
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahet në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: Florent ABRASHI
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Autoriteti Kontraktues dhe Operatori Ekonomik
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të

	<p>Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	---

